



**Peace
Corps**
MACEDONIA



Raporti vjetor 2017



Peace Corps

Mesazhi i Drejtorit



Mark Hannafin
Drejtore
Korpusi i paqes - Maqedoni
*(ish-vullnetar i Korpusit të paqes
në Kirgistan 1993-1995)*

“Çdo amerikan i ri i cili është pjesë e Korpusit të paqes dhe i cili punon në një vend të huaj, është i vetëdijshëm se e ndan qëllimin e madh të përbashkët për sigurimin e jetesës së pranueshme për njerëzit, që është themeli i lirisë dhe i paqes”.

— John F. Kennedy

Korpusi i Paqes në 22-vjetorin e ekzistimit të tij në Maqedoni ka shënuar të arritura mbresëlënëse. 79 burra dhe gra gjatë shërbimit të tyre në vitin 2017 kanë sjellë shkathtësitë, njohuritë dhe përvojat e tyre nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata kanë dhënë betimin se do të punojnë si vullnetarë në klube, në shkolla, në komuna dhe në organizata joqeveritare në komunitetet nëpër Maqedoni dhe kanë filluar të njihen me kulturën dhe me gjuhët që fliten në Maqedoni.

Këtë vit fokusi i punës sonë ishte përqendruar drejt sferave më të margjinalizuara të shoqërisë: njerëzit me aftësi të kufizuara, komunitetet rurale dhe të rinjtë. 25% të vullnetarëve kanë punuar në mjediset rurale. Vullnetarët kanë mbështetur 79 klube në komunitetet e tyre. Vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë punuar me 6200 fëmijë dhe të rinj. Në ndërkohë, ne kemi punuar me partnerët tanë për të arritur qëndrueshmërinë e projekteve të përbashkëta. Programi Modeli i Kombeve të Bashkuara, të cilën e filloi para shumë vitesh një vullnetar i Korpusit të Paqes, iu dorëzua zyrtarisht Koalicionit të organizatave rinore SEGA. Gjithashtu, çdo vit caktojmë nga një vullnetar i cili për vitin e tij të tretë të shërbimit punon me YMCA Manastir për të ndihmuar koordinimin e kampeve për vajzat dhe djemtë e rinj GLOW dhe YMLP.

Ne jemi shumë krenarë që përsëri punojmë me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë në fushën e nevojave të veçanta, arsimin dhe përparimin e gjuhës angleze dhe në zhvillimin e komuniteteve. Partneriteti ynë me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale po forcohet me plane të përbashkëta të punës, vizita dhe takime këshillimore për grante, si dhe duke identifikuar vendet e punës për vullnetarët e ardhshëm. Çdo ditë jemi mirënjohës për mikpritjen nga ana e Qeverisë, sektori civil, komunat dhe të gjithë familjet e mrekullueshme pritëse të vullnetarëve.

Shpresoj se do të jetë kënaqësi për ju për të mësuar më shumë për punën e Korpusit të Paqes. Të gjithë ne mund të bëjmë së bashku gjëra të mrekullueshme për ardhmërinë e Maqedonisë.

Shkurtimisht për Korpusin e Paqes

Në vitin 1961, Kryetari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Xhon F. Kenedi, formoi Korpusin e Paqes për të promovuar paqen dhe miqësinë botërore dhe sfidoi amerikanët për të jetuar dhe punuar në vendet në zhvillim. Kaluan më shumë se pesëdhjetë e pesë vjet nga formimi i Korpusit të Paqes, por misioni dhe roli i Korpusit të Paqes i bëri ballë testit dhe kohës. Tre qëllimet e Korpusit të Paqes mbeten po aq të rëndësishme aq sa ishin kur u formua ai:



Qëllimi 1: Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuar të përmbushin nevojat për individë të trajnuar.

Qëllimi 2: Të promovojë kulturën dhe vlerat amerikane te vendet në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Qëllimi 3: Të promovojë në Amerikë kulturën dhe vlerat e vendeve në të cilat vullnetarët shërbejnë.

Nga viti 1961, më shumë se 220 000 vullnetarët të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në 141 vende, dhe kanë lënë trashëgimi vlera të përbashkëta, marrëdhënie të përmirësuara dhe zhvillim të qëndrueshëm në komunitet. Në vitin 2017 rreth 7300 amerikanë kanë qenë vullnetarë në 60 vende nëpër tërë botën.

Korpusi i Paqes në Maqedoni



Korpusi i Paqes formoi programin e tij në Maqedoni në vitin 1996, me ftesë të Qeverisë së Maqedonisë. Që atëherë, rreth 750 vullnetarë kanë shërbyer në shkolla, komuna, organizata qytetare dhe institucione publike për të përmbushur nevojat e ndryshme të komuniteteve në vend. Si mirënjohje për rëndësinë e Korpusit të Paqes për përmirësimin e miqësisë maqedonase-amerikane dhe për detyrimin dhe përkushtimin e vullnetarëve në shoqërinë maqedonase, kryetari i Maqedonisë dhuroi Urdhrin e Meritës për Korpusin e Paqes në Maqedoni në vitin 2011.

Në vitin 2017 gjithsej 79 vullnetarë kanë shërbyer në njërin nga dy projektet e Korpusit të Paqes në Maqedoni, programin për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programin për zhvillimin e komunitetit, me fokus të veçantë në të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar.

Gjatë shërbimit të tyre në Maqedoni, vullnetarët njihen me kulturën lokale, mësojnë gjuhët lokale dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në jetën shoqërore. Pas mbërritjes në Maqedoni, vullnetarët kalojnë nëpër një trajnim intensiv për gjuhën, kulturën dhe shkathtësitë teknike. Për të lehtësuar integrimin e tyre në komunitetet lokale, vullnetarët jetojnë me familje-pritëse lokale gjatë trajnimit fillestar, por edhe gjatë periudhës prej 6 deri 24 muaj të shërbimit të tyre. Korpusi i Paqes ka bërë implementimin e programit të tij në Maqedoni përmes bashkëpunimit direkt me disa partnerë shtetërore dhe lokalë të cilët janë aktivë në sferën e arsimit, zhvillimin e komunitetit, punën me të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuar.

Në vitin 2017 Korpusi i Paqes në Maqedoni kishte memorandume aktive të bashkëpunimit me këta partnerë: Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë, Agjencinë së Rinisë dhe Sportit të Republikës së Maqedonisë, Këshillin Nacional Rinor të Maqedonisë dhe Koalicionin e Organizatave Rinore SEGA.





Peace Corps

Korpusi i Paqes në Maqedoni në vitin 2017:

2 projekte të Korpusit të Paqes në Maqedoni – programi për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze dhe programi për zhvillimin e komuniteteve

5 kampe verore “Nëpër botë”, organizuar në komunitetet rurale

7 memorandume të bashkëpunimit me partnerët

10 vullnetarë që kanë shërbyer në organizata dhe institucione për personat me aftësi të kufizuara

22 vjet të Korpusit të Paqes në Maqedoni

35 shkolla fillore dhe të mesme në të cilat kanë shërbyer vullnetarët

36 projekte në komunitet, implementimi i të cilave është bërë përmes programit për grante të vogla të Korpusit të Paqes

43 komuna në të cilat kanë jetuar dhe shërbyer vullnetarët

79 vullnetarë të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në Maqedoni

83 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme kanë bashkëpunuar me vullnetarët

92 organizata qytetare kanë punuar me vullnetarët

151 arsimtarë që kanë punuar me vullnetarët në zhvillimin e metodologjisë së punës me nxënësit me aftësi të kufizuara

150 persona me aftësi të kufizuara me të cilët kanë punuar vullnetarët

500 të rinj që kanë marrë pjesë në klubet GLOW dhe YMLP në komunitetet e tyre

6200 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të cilët kanë mësuar gjuhën angleze me ndihmën e një vullnetari

10000 persona, shumica të rinj, të cilët ishin pjesë e aktiviteteve për pjesëmarrje në komunitet, fitimin e shkathësitëve jetësore dhe vullnetarizëm

Projekti i zhvillimit të komunitetit

Projekti i zhvillimit të komunitetit në Maqedoni mbështet komunitetet dhe organizatat me qëllim të arritjes së një zhvillimi më efikas të qëndrueshëm të komuniteteve. Në vitin 2017 vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë punuar me organizatat qytetare, komunat lokale dhe institucionet publike të vendit.

Në vitin 2017 Korpusi i Paqes në Maqedoni në mënyrë shtesë fuqizoi angazhimin e tij në punën me të rinjtë dhe në punën me personat me aftësi të kufizuara, duke promovuar zhvillimin (grass-root) direkt të komunitetit. Në sferën e të rinjve, vullnetarët kanë organizuar aktivitete të përbashkëta me organizatat rinore dhe këshillat lokale rinore. Korpusi i Paqes ka rritur pjesëmarrjen e tij në sferën e punës me personat me aftësi të kufizuara, duke vendosur partneritete me qendrat ditore, shkollat për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe organizatat qytetare që punojnë me personat me aftësi të kufizuara.

Qëllimet e projektit për zhvillimin e komunitetit në punën me partnerët lokalë janë përmirësimi i kontributit të organizatave dhe grupeve joformale për identifikimin e nevojave të komunitetit; rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në komunitet dhe zhvillimi i shkathtësive të të rinjve si persona dhe qytetarë aktivë; dhe forcimi i kapaciteteve të organizatave për të përmirësuar cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet e mëposhtme ishin prioritet i vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe i bashkëpunëtorëve të tyre në vitin 2017:

- Mbështetja e organizatave në përcaktimin e nevojave të komunitetit dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike për t'ju përgjigjur nevojave të identifikuara
- Përmirësimi i shkathtësive të punonjësve në fushat e rëndësishme për zhvillimin organizativ
- Trajnimet e qytetarëve me qëllim të pjesëmarrjes së tyre në komunitet dhe fitimit të shkathtësive jetësore, si dhe ngritjes së ndërgjegjes për personat me aftësi të kufizuara
- Lehtësimi dhe organizimi i aktiviteteve për zhvillimin e shkathtësive jetësore tek të rinjtë, klubet rinore dhe kampet GLOW dhe YMLP, programet e udhëheqjes qytetare, Modelin e Kombeve të Bashkuara dhe garat shtetërore për spelling në gjuhën angleze



2

Projekte në Maqedoni

Projekti për përparimin e mësimdhënies në gjuhën angleze

Korpusi i Paqes në Maqedoni bëri implementimin e programit për përparimin e mësimdhënies së gjuhës angleze në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë, si dhe me agjenci dhe organizata të cilat janë përkushtuar për përmirësimin e mundësive arsimore. Në vitin 2017 vullnetarët kanë punuar në shkollat shtetërore fillore dhe të mesme të vendit, me theks në komunitetet rurale dhe të marginalizuara. Vullnetarët kanë ndihmuar arsimtarët e gjuhës angleze në mësimdhënie duke futur metoda për vënien e nxënësve në qendër të orës dhe për organizimin e orës, si dhe kanë dhënë ndihmë me klasat e përziera.



Qëllimet e programit për përparimin e mësimdhënies në gjuhën angleze janë: përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në shkolla, rritja e suksesit të nxënësve në të mësuarit e gjuhës angleze dhe forcimi i komunitetit shkollor. Me kërkesën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Korpusi i Paqes ka organizuar trajnime për arsimtarët e gjuhës angleze për punën me nxënësit me aftësi të kufizuara në orët e gjuhës angleze.

Aktivitetet e mëposhtme ishin prioritet i vullnetarëve të Korpusit të Paqes dhe i bashkëpunëtorëve të tyre-arsimtarë në vitin 2017:

- Ligjëratë e përbashkët me arsimtarët e gjuhës angleze;
- Futja e metodave për vënien e nxënësve në qendër të orës mësimore;
- Përgatitja e materialeve për orën mësimore;
- Mbështetja e arsimtarëve në zhvillimin e metodologjisë së punës me nxënësit me aftësi të kufizuara;
- Mësimdhënie në anglisht jashtë shkollës, në klube dhe aktivitete të tjera të lira;
- Të ndihmuarit e shkollave me aktivitete të projektit.

Sukseset e vullnetarëve

Unë jam vullnetar në një shkollë ku ka nxënës me aftësi të ndryshme të kufizuara të moshës nga klasa e tretë deri në të nëntën. Pasi mbërrita në vendin tim të punës, unë dhe bashkëpunëtorja ime identifikua detyrat e mia që do të jenë në gjendje për të ndihmuar më së shumti personat me aftësi të kufizuara gjatë orëve. Si rezultat i aftësive të ndryshme të kufizuara të nxënësve, unë dhe bashkëpunëtorja ime vendosëm të përqendrohemi në zhvillimin e materialeve edukative.



Gjatë vitit shkollor, bashkëpunëtori im më mësoi për lëndët që zakonisht i mësojnë në klasë të ndryshme. Në këtë mënyrë, unë mund të krijoja materiale shtesë për lëndë të caktuara, si për shembull, për gjuhën maqedonase, të cilat bashkëpunëtori im do të ishte në gjendje për t'i përdorur. Këto materiale shtesë përfshijnë: materialet për ushtrimin e matematikës etj. Gjithashtu, fillova të zhvilloj edhe materiale për nxënësit me autizëm.

Resurset për orët mësimore i bëra nga materialet lehtësisht të arritshme si për shembull, rotullat e letrës së higjienës, kutitë e kartonit, kutitë e kafeve, librat e vjetër dhe kutitë e barnave. Kjo na ndihmoi për t'u bërë të ndërgjegjshëm se materialet që zakonisht i hedhim, mund t'i përdorim përsëri në orët tona.

Përveç krijimit të materialeve edukative, unë dhe bashkëpunëtori im filluam të zbatojmë një mësimdhënie të përshtatur për nevojat e ndryshme të nxënësve. Futja e metodave diferencuese të mësimdhënies dhe vlerësimit me nota, përmirësoi suksesin e nxënësve. Sipas bashkëpunëtorit tim, këto metoda arsimore kanë lehtësuar mësimdhënien dhe të mësuarit për shkak se me to tema mund t'i përshtatet stilit individual të të mësuarit të nxënësit.

Sukseset e vullnetarëve

Shkolla e vullnetares Dejna në Shtip ka organizuar festime me rastin e festave maqedonase dhe ortodokse si Pashkët apo 1 Prilli gjatë orëve mësimore dhe në komunitet. Edhe krahas përbërjes së ndryshme etnike dhe numrit të madh të nxënësve romë, nuk u është kushtuar vëmendje e mjaftueshme festave të romëve dhe atyre të myslimanëve. Për këtë arsye, Dejna dhe bashkëpunëtorja e saj Gordana deshën të bëjnë të mundshme për nxënësit e tyre romë të festojnë kulturën e tyre.



Ato kanë organizuar një javë dhe orë dhe aktivitete shtesë fokusuar në ditën ndërkombëtare të romëve që është 8 Prilli. Nxënësit e klasës së katërt dhe të pestë kanë ndarë kulturën e tyre me shokët e tyre të klasës përmes muzikës dhe veçorive karakteristike, ndërsa Dejna dhe Gordana kanë mbajtur një orë të gjuhës angleze për flamurin rom, duke përdorur simbole dhe ngjyra për të qenë nxënësit në gjendje të ushtrorjnë përshkrimin në gjuhën angleze. Në fund të javës, të gjithë nxënësit e klasës së katërt dhe të pestë ishin ftuar për të festuar në Këndin lokal Amerikan, ku nxënësit e kanë bërë flamurin rom nga materialet e ricikluara dhe, gjithashtu, kanë luajtur lojëra, kanë dëgjuar muzikë dhe kanë ngrënë çokollata.



“Kjo ishte një ngjarje e mrekullueshme për nxënësit tanë dhe një mundësi për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të folur për zakonet dhe ngjarjet tradicionale rome”, tha Gordana. “Unë isha shumë e lumtur që isha dëshmitare e punës ekipore të nxënësve tanë dhe bashkëjetesës së tyre”.

Trajnimi dhe orientimi i familjeve të personave me aftësi të kufizuara



Noemi dhe bashkëpunëtorja e saj kanë organizuar një seri punëtorish për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe kanë përgatitur një doracak për prindërit në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Si shtesë e shërbimeve për prindërit që tanimë i ka ofruar “Lastovica”, me ndihmën e këtij projekti organizata ka shtuar konsultime të rregullta mujore dhe trajnime për prindërit.

Punëtoritë janë organizuar si pjesë e një trajnimi dyditor “Ndihma, mbështetja dhe drejtimet për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara”. Gjatë kësaj ngjarjeje, prindërit kanë marrë informacione në lidhje me përfitimet sociale, arsimore dhe shëndetësore që u takojnë nga ana e shtetit. Punëtoritë janë ofruar falas për gjithsej 50 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara të Gostivarit, Shtipit, Shkupit dhe vendet e banuara të rrethinës.

Me qëllim të përfshirjes së barabartë të personave që i flasin gjuhët më të përfaqësuara në Maqedoni, trajnimet janë mbajtur në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Doracakët, gjithashtu, janë botuar në të dyja gjuhët. Çdo prind që ka marrë pjesë në njërin nga punëtoritë ka marrë një ekzemplar të doracakut, dhe në ueb-faqen e “Lastovica”-s në mënyrë shtesë është publikuar versioni elektronik dhe është ndarë përmes medimeve sociale.

Në këto punëtori u zhvilluan diskutime të frytshme ndërmjet edukatorëve specialë dhe prindërve. Dëshmi për suksesin e projektit ishte ajo se si rezultat i tij, prindërit nga Shkupi vendosën një praktikë për takime mujore me qëllim të shkëmbimit të burimeve dhe ndarjes së informacionit.



Gratë në gazetarinë, mediumet dhe komunikimin

Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte të mbështeten vajzat e reja për të drejtuar zhvillimin e tyre të karrierës në fushat e gazetarisë, mediumeve dhe komunikimit. Përmes takimeve mujore, trajnimeve dhe me ndihmën e teknologjisë që është siguruar nga ky projekt, një grup nxënësish nga Vinica, kryesisht vajza, morën një përvojë praktike nga gazetaria e shtypur dhe ajo televizive.

Projekti, gjithashtu, ndihmoi vajzat nga Vinica për të zhvilluar shkathtësitë në fushat e fotografisë, komunikimit digjital dhe mediumeve.

Përveç që morën përvojë duke themeluar dhe udhëhequr një klub të gazetarisë, ato kanë mësuar të përdorin pajisjen profesionale të fotografimit dhe kanë marrë shkathtësitë themelore të redaktimit dhe dizajnit. Anëtarët e klubit të gazetarisë kanë marrë edhe një trajnim në temën e udhëheqjes dhe kanë pasur mundësinë për të mësuar për punën e grave të suksesshme fotografe.



Bashkësia lokale ka dhënë mbështetje të madhe për këtë projekt. Nga ana e mediumeve lokale u transmetuan informacionet për ekspozitën e fotografive të nxënësve të përfshirë në këtë projekt, dhe reagimet e qytetarëve të Vinicës ishin shumë pozitive.



Sukseset e vullnetarëve



Pasi mbërriti në Kriva Pallankë në dhjetor të vitit 2016, vullnetari Kajl zhvillon një program jashtë mësimor për mbrojtjen shëndetësore me më shumë se 200 të rinj, djem dhe vajza të moshës nga 6 deri 17 vjeç. “Atletët” (siç e quajnë veten anëtarët e projektit “Ekipi Kriva Pallanka”) marrin pjesë në trajnimet javore të atletikës që kanë për qëllim t’u ndihmojnë atyre për t’u bërë qytetarë të shëndetshëm, aktivë dhe liderë të komunitetit, të përgatitur për të zhvilluar veten dhe komunitetin e tyre. Duke përdorur gjuhën e sportit, “Ekipi Kriva Pallanka” përgatit të rinjtë për fitore në sport dhe në jetë duke fituar ata shkathtësi dhe

përvoja për këtë gjë.

“Ekipi Kriva Pallanka” u jep mundësinë nxënësve për pjesëmarrje aktive në zhvillimin e tyre mental dhe fizik. Përveç në trajnimet javore të atletikës, që zhvillojnë frymën atlete, koordinimin dhe lëvizshmërinë e këllqeve, të gjithë sportistët marrin pjesë edhe në trajnimet për fitimin e shkathtësive në fushën e shëndetit dhe higjienës, punës ekipore. Projekti promovon edhe konceptet më të avancuara, siç është forcimi i grave përmes sportit, demokracia dhe ekologjia. Kur prezantohen përmes sportit, është dëshmuar se këto shkathtësi dhe koncepte përshpejtojnë proceset e të mësuarit dhe mund të zbatohen në aspekte të tjera të jetës së sportistëve.

“Ekipi Kriva Pallanka” mori mbështetjen e Programit për grante të vogla të Korpusit të Paqes në janar të vitit 2018. Projekti në mënyrë plotësuese zgjeroi punën aktuale dhe ka për qëllim përmirësimin e shëndetit fizik të pjesëmarrësve për 50% që do të tregohet me testim dhe me ndjekjen e lëvizshmërisë së këllqeve, fleksibilitetit, stabilitetit, fuqisë dhe eksplozivitetit, si dhe përgatitjen e trajnerëve lokalë të sportit për të marrë tërë programin deri në 1 qershor. Të gjitha trajnimet janë regjistruar nga ana e trajnerëve të klubeve sportive dhe janë publikuar në YouTube dhe në Facebook.



Financimi është shfrytëzuar për t’u furnizuar me pajisje themelore atletike dhe sportive dhe për organizimin e dy kampeve të grave të udhëhequra nga sportistë profesionalë të Maqedonisë (karate dhe basketboll), në të cilët morën pjesë 100 sportiste femra të moshës nga 6 deri 17 vjeç.

Dëshmia e Besnik Selimit – bashkëpunëtor

Bashkëpunimi ndërmjet vullnetarit tonë të Korpusit të Paqes dhe komunitetit ishte një përvojë shumë e madhe. Ekzistojnë përfitime të shumta nga puna me një vullnetar të Korpusit të Paqes. Disa prej tyre përfshijnë komunikimin me një folës të lindur të gjuhës angleze, zbulimin e një perspektive më ndryshe për mësimdhënien dhe punën me nxënësit, dhe të mësuarit e një kulture dhe sistemi arsimor të ndryshëm. Në mënyrë plotësuese, komuniteti jashtë shkollës ka dobi nga vullnetarët e Korpusit të Paqes kur ata organizojnë aktivitete të ndryshme me të rinjtë lokalë, siç janë kurset e gjuhës angleze dhe klubet e sportit.



Përmes përvojës sime me punën me një vullnetar, vërejta rritjen e notave të nxënësve në gjuhën angleze, si dhe një përqendrim më të madh gjatë orëve. Nxënësit më shumë bashkëpunojnë dhe ndihen më të sigurt për të lëvizur në klasë, të përgjigjen në pyetjet dhe të gjejnë zgjidhjet. Duke përdorur qasjen e fokusuar në nxënësit zbulova se ata janë shumë më të interesuar për aktivitete interaktive dhe lojërat e gramatikës dhe komunikimit, se sa për qasjen klasike.

Duke përdorur teknologjinë informatike, vullnetarja Laura ua prezantonte nxënësve kulturën dhe festat amerikane. Në këtë mënyrë, nxënësit mësuuan për atë se si festohen festat në një vend tjetër. Gara shtetërore në shkrimin e eseve dhe Gara shtetërore në spelling në gjuhën angleze edhe më shumë ua afruan nxënësve tanë gjuhën angleze dhe i motivuan ata për të garuar me nxënësit e shkollave të tjera.

Si përfundim, bashkëpunimi me vullnetarin e Korpusit të Paqes nuk është vetëm për mësimdhënien në gjuhën angleze, por edhe për t'u dhënë shpresë dhe motivim nxënësve për të bërë ndryshim për një zgjedhje më të mirë në jetë. Korpusi i Paqes me të vërtetë sjell shpresë dhe paqe.

Dëshmia e Snezhana Saramandovës – bashkëpunëtore e një vullnetari

A keni pyetur veten ndonjëherë pse njerëzit shërbejnë si vullnetarë? Çfarë dobie kanë? Pse braktisin punën, shtëpitë dhe familjet e tyre dhe udhëtojnë nga Amerika deri në Maqedoni për t'u bërë vullnetarë në ndonjë organizatë ose komunë? Përgjigja ime për të gjitha këto pyetje është: përvoja e pasur që merr personi nga puna, dhe në të njëjtën kohë të jetë në gjendje për t'iu gëzuar rezultateve.

Fondacioni Apollonia është një organizatë e vogël, por është aktive dhe jofitimprurëse që punon 10 vitet e fundit në Maqedonisë Juglindore. Organizata jonë kishte kënaqësinë për të bashkëpunuar me një numër të madh vullnetarësh të Korpusit të Paqes në 9 vitet e fundit.



Disa nga projektet në të cilat kanë punuar me vullnetarët tanë në të kaluarën përfshijnë: punën në terren me fëmijët në kuadër të programit ekologjik i quajtur Dita e natyrës, riciklimi i plastikës, vendosja e hapësirave sensorike për fëmijët me aftësi të kufizuara, hapja e një qendre vullnetare të resursit për të rinjtë, shkrimi dhe menaxhimi i granteve, inicimi i programit profesional për riciklimin e letrës në qendrën ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara, aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit, mbrëmje filmi për të rinjtë, orë të gjuhës angleze, pastrim, konferenca ekologjike dhe shumë ngjarje të tjera.

Por përfitimi kryesor nga ky bashkëpunim nuk mund të matet me projektet që i filluan vullnetarët. Personalisht fitova miq për tërë jetën dhe fitova një kënaqësi të madhe nga puna e përbashkët, nga zhvillimi im personal dhe profesional.



Falë punës me vullnetarët, anglishtja ime është përmirësuar, u bëra më e organizuar dhe mësova shumë për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve, shkrimin e granteve, hulumtimin dhe vendosjen e partneriteteve dhe gjithë këtë në mënyrën më të mirë – përmes të mësuarit eksperimental. Çdonjëri nga vullnetarët me të cilët kemi punuar, ka lënë një shenjë personale, dhe ka rol të rëndësishëm në formësimin dhe zhvillimin e Fondacionit Apollonia.

500

Të rinj të klubet GLOW dhe YMLP



Roli i programeve për zhvillimin rinor GLOW (Vajzat që udhëheqin botën) dhe YMLP (Kamp lider për djemtë e rinj) është për të zhvilluar potencialet e të rinjve në Maqedoni duke u mundësuar që të zhvillojnë njohuritë dhe shkathtësitë e domosdoshme për t'u bërë liderë aktivë në komunitetet e tyre. Kjo realizohet përmes të mësuarit eksperimental në të dy kampet dhe klubet e shumta nëpër Maqedoni në të cilat festohen ndryshueshmëritë, ndërtohen kompetenca akademike dhe shoqërore dhe promovohet përdorimi i gjuhës angleze. Fokusi i programeve për zhvillimin rinor GLOW dhe YMLP është krijimi i dëshirës tek të rinjtë për të qenë vullnetarë dhe për të shërbyer në komunitet.

Në këto kampe, pjesëmarrësit kanë mësuar si të veprojnë në komunitetet e tyre përmes simulimit të projektit të vullnetarizmit. Përmes kësaj, kamperët kanë zhvilluar vetëdijen për mundësitë e vullnetarizmit në komunitetet e tyre, kanë mësuar si të njohin nevojat potenciale dhe si të përdorin resurset të cilat i kanë në dispozicion.

Pas përfundimit të kampeve GLOW dhe YMLP vjen pjesa më e mirë e vitit – formimi i klubeve rinore GLOW dhe YMLP dhe zbatimi i projekteve në komunitetet e kamperëve. Fondi rinor i GLOW dhe YMLP, mbështetur nga IMKA Manastir, u ofron mundësi klubeve GLOW dhe YMLP për implementimin e shkathëtsive që i kanë fituar kamperët gjatë kampit. Në rrethin e parë të aplikimit për grante, për 7 klube GLOW dhe YMLP janë miratuar grante bazuar në propozim-projektet e tyre të shkruara nga ana e liderëve të tyre rinorë në fushën e mjedisit jetësor, përfshirjes qytetare dhe artit. Çdo projekt individualisht, është zbatuar për më pak se 100 dollarë.

Një nga projektet e realizuara përmes Fondit rinor është edhe projekti i implementuar nga klubi GLOW/YMLP në Ohër, ku është mbajtur një ngjarje për riciklimin e pajisjes elektronike në Shkollën e Mesme “Sh. Kirili dhe Metodi” në Ohër. Me ndihmën e drejtorit dhe punonjësve të shkollës, si dhe të kompanisë së riciklimit të Shkupit, klubi grumbulloi një pjesë të madhe të pajisjes elektronike nga shkolla dhe e dërgoi në Shkup për riciklim të mëtejshëm të sigurt të saj. Lideri i klubit rinor në Ohër, Filipi, i cili ishte pjesëmarrës i kampit YMLP në vitin 2017 tha: “Ajo që më pëlqeu më së shumti nga projekti që e realizuam është fakti se frymëzuam një numër shumë të madh njerëzish në shkollën tonë për të qenë vullnetarë dhe për të na ndihmuar në mënyrë të duhur të lirohemi nga të gjitha aparatet e panevojshme elektronike. Pas përfundimit të projektit, të gjithë ne që ishim vullnetarë ndiheshim të përmbushur dhe të lumtur për shkak se zbrazëm një hapësirë të madhe në shkollë pasi që u liruar nga e gjithë elektronika e panevojshme. Jam shumë krenar dhe i lumtur për shkak të ndihmës nga shkolla, nxënësit, ekipi i riciklimit nga Shkupi, si dhe anëtarët e klubit rinor.

10000

Pjesëmarrës në aktivitetet e bashkësive lokale

Kampet verore “Nëpër botë”

Verën e kaluar, në qytetet dhe fshatrat nëpër Maqedoni pjesëmarrësit patën mundësinë për të udhëtuar “nëpër botë” gjatë kampeve “Nëpër botë” 2017. Në korrik dhe në gusht, vullnetarët e Korpusit të Paqes organizuan dhe ishin nikoqirë të pesë kampeve njëjavore në vendet e tyre të banimit. Nxënësit lokalë, më së shpeshti të moshës nga 8 deri 12 vjeç, morën pjesë në këto aktivitete të popullarizuara verore me një entuziazëm të madh. Kampet u mbajtën në shkolla në vendbanime më të shumëllojshme – nga fshatrat më të vogla me popullsi prej 250 banorëve deri në qytetet e mëdha me popullsi prej 36 000 banorësh, në komunitete me popullsi maqedonase, shqiptare, turke, rome, si dhe grupe të tjera etnike.



Çdo ditë të kaluar në kamp, kamperët kanë mësuar për kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme, përmes aktiviteteve interaktive. Vendet që u zgjodhën për kampet në vitin 2017 ishin: India, Peru, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Egjipti dhe Zelanda e Re. Aktivitetet që u bazuan në ligjërata, kanë përfshirë: sportet ndërkombëtare, lojërat, artet dhe muzikën. Qëllimi i këtyre kampeve ishte që kamperët të përmirësojnë përdorimin e gjuhës angleze dhe të zhvillohet një ndërgjegje më e madh kulturologjike tek kamperët dhe në komunitetet e tyre. Qëllimi i parë u realizua duke përdorur gjuhën angleze si gjuhë të punës në kampet, duke e plotësuar atë me gjuhët lokale sipas nevojës. Kamperët zhvilluan një vetëdije më të madhe për kulturat e ndryshme, duke treguar kureshtje dhe demonstruan njohuri për vendet e reja dhe aspektet e kulturës së tyre.

Kampet “Nëpër botë” përfaqësuan një mundësi të shkëlqyer për të përfshirë të rinjtë në proceset edukative, të cilat ndryshojnë nga orët e tyre standarde në shkollë. Përgjithësisht, vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe bashkëpunëtorët lokalë ishin në gjendje për të vërejtur si kampet ngritën zhvillimin personal dhe social të kamperëve, përmes mënyrës në të cilën bashkëpunonin me shokët e tyre të klasës gjatë kampit. Kamperët u përfshinë në aktivitete argëtuese dhe fizike përmes aktiviteteve të planifikuara ditore, siç janë: të mësuarit e valles tradicionale “haka” të Maorëve dhe “Vajtimin e luftës” së Zelandës së Re. Ata fituan ndjenjën e plotësisë dhe të shprehurit kreativ përmes këndimit dhe vizatimit, si për shembull, dekorimi i “sistrum”-it – një instrument i vjetër egjiptian. Kamperët vendosën një komunikim pozitiv përmes punës grupore, muzikës dhe sportit në një proces të strukturuar i udhëhequr nga këshilltarët e kampit, i orientuar drejt pjesëmarrjes së tyre aktive.

10000

Pjesëmarrës në aktivitetet e bashkësive lokale

Programi Tek-ap (TechUP)

Programi “Tek-ap” është krijuar nga një vullnetar i Korpusit të Paqes në Gostivar dhe dy semestrat e fundit akademikë është mbajtur në qytetin e dytë për nga madhësia në Maqedoni, Manastir. Programi “Tek-ap” është një program praktik për zhvillimin e kapaciteteve të nxënësve të shkollave të mesme për programimin kompjuterik.

Në orët fillestare në Manastir, nxënësit kanë mësuar për bazat e HTML dhe CSS nëpërmjet instruksioneve dhe ushtrimeve interaktive në laboratorin kompjuterik (i siguruar nga Këndi Amerikan në Manastir). Gjatë kursit për nivelin e mesëm, gjashtë nxënës morën përvojë praktike duke krijuar ueb-faqe të thjeshta për organizatat në bashkësitë lokale, siç është forumi i prindërve kujdestarë dhe grupi i përkushtuar për të siguruar materiale të specializuara edukative për arsimtarët.

Grupet takoheshin pas mësimit të rregullt dhe të shtunave. Fakti që nxënësit ndanë një pjesë të madhe të kohës së tyre të çmueshme, dëshmon për mundësitë e programit për të mbajtur vëmendjen e tyre. Grupet jo vetëm që mësuan të programojnë, por gjithashtu, mësuan edhe si të punojnë në ekip, si të përgjigjen në nevojat e klientëve të tyre dhe për përgjegjësinë e krijimit të një produkti përfundimtar.

Programi në Manastir u krijua nga ana e një vullnetari të Korpusit të Paqes, por me rëndësi është të përmendim se ai funksionoi me një mbështetje të vogël të vullnetarit. “Tek-ap” u zbatua nga ana e instruktorëve lokalë, dedikuar për të rinjtë lokalë dhe ofron ueb-faqe falas për organizatat lokale (të krijuara gjatë orëve për nivel mesatar). Kjo krijon të drejtën e pronësisë së bashkësisë lokale dhe qëndrueshmërisë në mënyrë që programi të mund të vazhdojë pasi të përfundojë shërbimi i vullnetarit.



10000

Pjesëmarrës në aktivitetet e bashkësive lokale

Dorëzimi i MMKB-së për SEGA-n

Si pjesë e përpjekjeve afatgjata të Korpusit të Paqes për ndërmarrjen e projekteve nga ana e organizatave lokale, në shtator të vitit 2017, Korpusi i Paqes zyrtarisht ia dorëzoi projektin Modeli Maqedonas i Kombeve të Bashkuara (MMKB) partnerit lokal Koalicionit të organizatave rinore SEGA – një rrjet nacional i shpërndarë i organizatave joqeveritare, të cilat punojnë në zhvillimin e të rinjve. Në gjashtë vitet e fundit SEGA ka punuar me vullnetarët e Korpusit të Paqes për të bërë implementimin e projektit MMKB në nivel nacional, duke trajnuar 500 të rinj për simulimin e Modelit të Kombeve të Bashkuara. Të rinjtë fituan shkathtësi të hulumtimit, debatit, të folurit publik, zgjidhjes së problemeve, si dhe të folurit të gjuhës angleze.

Me çdo ngjarje të MMKB, vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë ndihmuar punonjësit në SEGA për të qenë në gjendje në mënyrë të pavarur të bëjnë implementimin e projektit në aspektin programor dhe logjistik. Në vitin 2017, me mbështetjen e një vullnetari të Korpusit të Paqes, SEGA nisi një nismë për të mbledhur fonde për ngjarjen duke paguar një tarifë për pjesëmarrje, duke eliminuar kështu nevojën për grante të jashtme dhe siguruan stabilitet financiar.



MMKB është vlerësuar shumë nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit dhe ka arritur të tërheqë mbi 70 pjesëmarrës, pavarësisht nga pagesa e tarifave. Si pjesë e ligjëratës për kompetencën, një vullnetar i Korpusit të Paqes dhe kolegët nga koalicioni SEGA kanë hartuar një doracak për MASH-in, i cili shërben si udhëzues programor, administrativ dhe logjistik për fillimin dhe implementimin e Modeleve të ngjashme të Kombeve të Bashkuara edhe në vende të tjera.



Korpusi i Paqes në Maqedoni në 2017




79

Vullnetarë të
Korpusit të Paqes

92 Partnerë të
organizatave të
shoqërisë civile



500



Të rinjë në klubet
YMLP dhe GLOW


11

Vullnetarë
vazhduan
shërbimin e tyre
për një vit
të tretë

10,000



Pjesëmarrës në aktivitetet
e komunitetit



22

Vjet në
Maqedoni



35

Nga shkollat fillore dhe të
mesme u shërbyen nga
vullnetarët



73

Klube të drejtuara nga
vullnetarë nëpër Maqedoni

Komuna ku u zbatuan grantet
e vogla për paqe

26




\$73,165

Ofruar projekteve të
komunitetit nëpërmjet
programit të Korpusit të
paqes për grante të vogla

6,200

Studentë të mësuar nga
vullnetarët

Duke ju shërbyer vullnetarëve
të korpusit të paqes në
rajone



Nga të gjithë
vullnetarët
shërbyen në
rajone rurale

72%

Nga gjithë vullnetarët
zgjedhin të jetojnë me
familjet nikoqire gjatë tërë
shërbimit të tyre

